



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE
DREJTORIA E FINANCËS, BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE

Nr. 365 Prot.,

Tiranë, më 20.02.2025

Lënda: Dërgohet raporti mbi realizimin e zërave të investimeve të akorduara në buxhet për vitin 2024, për Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
Rruga "Dëshmorët e 4 shkurtit", Tiranë

Të nderuar,

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 27.12.2022 "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike", i ndryshuar, po ju paraqesim informacionin narrativ mbi ecurinë e realizimit të fondeve për investime për periudhën janar – dhjetor 2024.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në zbatim të Ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", i ndryshuar, gjatë vitit 2024 pati ecuri të realizimit të fondeve kapitale sipas tabelës të mëposhtme:

- **REALIZIMI I SHPENZIMEVE KAPITALE SIPAS TAVANEVE BUXHETORE
PËR PERIU DHËN JANAR – DHJETOR 2024**

Në lekë

Artikulli	EMËRTIMI	VLERA NË FILLIM TË VITIT NË BUXHET	VLERAT PAS NDRYSHIME VE	FAKTI I REALIZIMIT TË BUXHETIT		FAKTI SHPENZIME THESAR JANAR – DHJETOR (I+II)	PËRQIND JA E REALIZI MIT (%)
				JANAR – MARS (I)	PRILL - DHJETOR (II)		
231	Shpenzime për rritjen e aktiveve	5,170,000	54,230,000	0	52,415,970	52,415,970	97

	qëndrore të trupëzuara (Buxheti Shtetit)						
231	Shpenzime për rritjen e aktiveve qëndrore të trupëzuara (Financim i huaj)	8,300,000	3,800,000	1,093,828	2,699,335	3,793,163	100
Total llogaria 231		65,300,000	58,030,000	1,093,828	55,115,305	56,209,133	97

Më poshtë lutemi të gjeni analizë më të detajuar për çdo projekt investimi sipas këtyre pikave:

a. Vlerësim të përgjithshëm mbi arritjet dhe problematikat mbi ecurinë e projektit të Investimeve Publike për vitin 2024;

- **Projekti “Blerje pajisje elektronike AIDA” – kodit 24AE101**

Ky projekt u financuar gjatë vitit 2024 me kërkesë tonë për ndryshim destinacionit të fondeve të akorduara për një projekt tjetër i cili nuk gjeti realizim gjatë vitit 2024 nën titullin: ”Përmirësim sistemesh”. Nevoja për këtë financim erdhi në kuadër të riskstrukturimit të AIDA-s, proces i cili u shoqërua me shtesë stafi me 12 punonjës të rinj. Kërkesa jonë u miratua nga MEKI dhe me shkresën e MF me nr. 10001/1 prot., datë 08.08.2024, fondit ju ndryshua destinacioni. Në vijim me shkresën tonë me nr.1393/2 prot., datë 16.08.2024 drejtuar AKSHI-t, kemi kërkuar ndjekjen e procedurës të prokurimit të fondit prej 1,666,666 lekë pa TVSH sipas sasive dhe specifikimeve të kërkuara nga AIDA.

Në përfundim të procedurës të ndjekur nga AKSH-i u lidh kontrata me 2(dy) operator ekonomik për furnizimin me 10 PC dhe 4 UPS. Këto pajisje krijuan kushtet e nevojshme për sigurimin e infrastrukturës TIK për stafin e ri, duke përmbushur nevojën e institucionit dhe qëllimin për të cilën këto fonde u kërkuar, sipas dhe analizës të bërë në projekt FISHKAT.

- **Projektet për mbështetje të bizneseve me grantë për investime kapitale:**

- 1.Projekti “Fondi i konkureshmërisë” – kodit M100368
- 2.Projekti “Fondi i inovacionit” – kodit M100369
- 3.Projekti “Fondi i start up” – kodit M100370
- 4.Projekti “Fondi i biznesit kreativ” – kodit M100371

AIDA ndërmorri të gjithë hapat e nevojshëm për përgatitjen dhe miratimin e “Fondit për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2024”. Pas miratimit të VKM-ve referuar

procedurës së shpërndarjes dhe fushat e mbështetjes, fondi u çel me 12 Korrik 2024 dhe qëndroi i hapur për aplikime deri me 11 Gusht 2024.

Për vitin 2024, u akordua shuma prej 51,830,000 lekë, për grante me fonde kapitale, ku rezultuan fitues 47 subjekte nga të cilët 28 fitues – projekti konkurrueshmëria, 6 fitues – projekti inovacioni, 6 fitues – projekti artizanati dhe 7 – projekti start-upet. Realizimi i këtyre projekteve ka qenë në masë 100%. Mbështetja me grante për drejtuese femra ka qenë në masë 49 % ose 23 subjekte nga 47 përfitues. Shpërndarja e këtyre fondeve nuk ka patur problematika.

- **TVSH për projekte me financim të huaj – kodi M100332**

Fondet e akorduara nën këtë projekt lidhen me ecurinë e projekteve me financim të huaj dhe vlerat e faturave me TVSH që do gjenerohen gjatë implementimit të aktiviteteve të këtyre projekteve. Gjatë vitit 2024 AIDA ndoqi zbatimin e aktiviteteve për projektin me financim të huaj “Skills for jobs Albania Montenegro”, projekt i cili pati ecuri shumë të kënaqëshme sipas objektivave, por që gjeneroj pak fatura me TVSH, ndaj dhe realizimi i këtj zëri ishte i ulët.

b. Mospërputhjet mes ecurisë fizike të projektit dhe planit të financimit duke argumentuar mospërputhjet:

- **Projekti “Blerje pajisje elektronike AIDA” – kodi 24AE101**

Fondi i mbetur papërdorur nga procedura e ndjekur nga AKSH për këtë projekt, u rihodh për prokurim nga AIDA në muajin dhjetor 2024, por për shkak se Operatorët Ekonomik të klasifikuar nga sistemi APP si potencial u tërhoqën, procedura dështoi. Duke qenë se ishim në fund të vitit 2024 nuk patëm kohë për rihedhjen e tenderit, duke sjellë kështu realizim faktik nga planifikimi në masë 816,456 lekë ose 41% të fondit të planifikuar.

- **Projektet për mbështetje të bizneseve me grantë për investime kapitale:**

- 1.Projekti “Fondi i konkurrueshmërisë” – kodi M100368
- 2.Projekti “Fondi i inovacionit” – kodi M100369
- 3.Projekti “Fondi i start up” – kodi M100370
- 4.Projekti “Fondi i biznesit kreativ” – kodi M100371

Realizimi i këtyre projekteve ka qenë në masë 100%.

- **TVSH për projekte me financim të huaj – kodi M100332**

Fondet e akorduara nën këtë projekt lidhen me ecurinë e projekteve me financim tuaj dhe sasinë e faturave me TVSH që do gjenerohen gjatë implementimit të aktiviteteve të këtyre projekteve. Gjatë vitit 2024 AIDA ndoqi zbatimin e aktiviteteve për projektin me financim të huaj “Skills for jobs Albania Montenegro”, por që gjeneroj pak fatura me TVSH, ndaj dhe realizimi i këtj zëri ishte i ulët, vetëm 1%.

c. Projektet e investimeve për të cilat mund të jenë krijuar detyrime të prapambetura dhe arsyet e krijimit të tyre:

Nuk kemi projekte të tilla investimesh.

d. Afatet e nisjes së zbatimit dhe përfundimit të projektit:

- **Projekti “Blerje pajisje elektronike AIDA” – kodi 24AE101**

Nisja e zbatimit në muajin gusht 2024 – përfundimi në muajin shtator 2024 me lidhjen e kontratave me OE fitues.

- **Projektet për mbështetje të bizneseve me grantë për investime kapitale:**

1. Projekti “Fondi i konkureshmërisë” – kodi M100368
2. Projekti “Fondi i inovacionit” – kodi M100369
3. Projekti “Fondi i start up” – kodi M100370
4. Projekti “Fondi i biznesit kreativ” – kodi M100371

Nisja e zbatimit në muajin shtator 2024 (me lidhjen e marrëveshjeve me përfituesit e fondeve) – përfundimi në muajin nëntor 2024 sipas afateve në marrëveshjeve.

- **TVSH për projekte me financim të huaj – kodi M100332**

Nisja në muajin janar 2024 – dhjetor 2024.

e. Ecurinë e ndikatorëve të performancës:

- **Projekti “Blerje pajisje elektronike AIDA” – kodi 24AE101**

Treguesit e këtij projekti janë realizuar plotësisht. Konkretisht nga 14 pajisje të parashikuara për tu siguruar me këto fonde, janë blerë 10 PC dhe 4 UPS.

- **Projektet për mbështetje të bizneseve me grantë për investime kapitale:**

1. Projekti “Fondi i konkureshmërisë” – kodi M100368
2. Projekti “Fondi i inovacionit” – kodi M100369
3. Projekti “Fondi i start up” – kodi M100370
4. Projekti “Fondi i biznesit kreativ” – kodi M100371

Treguesit e performancës për këto projekte dëshmojnë për arritje të sukseshme, pasi të gjithë janë tejkaluar nga parashikimi, konkretisht;

Numri i NVMV-ve të mbështetura me fonde publike – nga 46 subjekte të parashikuar për tu mbështetur janë realizuar 47 marrëveshje për grante, nga të cilat nga 12 drejtuese femra që parashikoheshin janë realizuar 23 të tilla.

- **TVSH për projekte me financim të huaj – kodi M100332**

Ky projekt investimi nuk ka një indikator të mirëfillt pasi lidhet me ecurinë e projekteve me financim të huaj dhe me faturimin me TVSH të aktiviteteve në kuadër të këtyre projekteve.

f. Komente mbi problematikat që kanë ndikuar ecurinë e projektit.

Problematika kemi hasur në realizimin e plotë të vlerës të buxhetuar për projektin ‘Blerje pajisje elektronike AIDA’, pasi procedura e dytë e nisur për tu ndjekur për këtë projekt nga AIDA dështoi për shkak të afateve të nevojshme të procedurës në APP.

g. Projektet të cilat nuk u arritën që të realizohen gjatë vitit buxhetor duke argumentuar arsyet e mosrealizimit.

Projekti “Përmirësim sistemesh”, nuk ka mundur të realizohet në vitin 2024 pasi ky projekt lidhej me mirëmbajtjen e sistemit të Regjistrimit të Investimeve Strategjike, i cili nuk u finalizua dot në vitin 2023. Ndaj fondi i akorduar për këtë zë u devijua në projektin “Blerje pajisje elektronike AIDA”.

h. Projektet të cilat janë mbyllur përfundimisht gjatë vitit buxhetor si dhe evidentimin e rasteve kur afati i përfundimit, vlera përfundimtare e projektit dhe cilësia ka devijancë nga afati, vlera fillestare dhe cilësia e parashikuar, njëkohësisht duke argumentuar devijancat.

Projektet e investimeve të financuara për vitin 2024 janë realizuar, si dhe ska devijanca në afate apo vlera përfundimtare.

i. Projektet e mbyllura përfundimisht, mbi arritjen e rezultateve të synuara për perfituesit nga zbatimi i projektit.

Arritjet e projekteve janë përmendur dhe më lartë, në sqarimin e treguesve të indikatorëve.

j. Statusin fizik të projekteve të cilat janë në proces dhe vijojnë në vitin buxhetor pasardhës si dhe duke evidentuar veçmas ato projekte që janë në vonesë realizimi.

Në projekte me fonde kapitale që vijojnë dhe këtë vit kemi fondet kapitale për mbështetje me grante, si Fondi Konkurrueshmërisë dhe Fondi për Biznesin Kreativ. Këto fonde akordohen çdo vit nga Buxheti Shtetit dhe shpërndahen brenda viti buxhetor kundrejt përcaktimeve dhe fushave të mbështetjes të diktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave çdo vit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR EKZEKUTIV

LAURA PLAKU (SARO)

Rruga “Skërdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë
Tel: +355 (0)42251001, <http://www.aida.gov.al>, e-mail: info@aida.gov.al

